

STRABAG AG – DEGE E SHOQERISE SE HUAJ
Pasqyrat Financiare për vitin e mbyllur më 31 Dhjetor 2014
Së bashku me Raportin e Audituesit të Pavarur

Përmbajtja

	Faqe
Raporti i Audituesit të Pavarur	1
Pasqyrat Financiare	
Pasqyra e pozicionit financiar	2
Pasqyra e të ardhurave gjithëpërfshirëse	3
Pasqyra e ndryshimeve në kapital	4
Pasqyra e rrjedhjes së parasë	5
Shënime mbi pasqyrat financiare	6 - 19

RAPORT I AUDITUESIT TE PAVARUR

Drejtuar: Menaxhimit dhe Ortakeve të Shoqërisë Strabag AG – Dege e Shoqërisë se Huaj

Raporti mbi Pasqyrat Financiare

Ne kemi audituar pasqyrat financiare të bashkangjitura këtij raporti të shoqërisë Strabag AG – Dege e Shoqërisë se Huaj (në vijim referuar si "Shoqëria") që përfshijnë pasqyrën e pozicionit financiar më datë 31 Dhjetor 2014 si dhe pasqyrën përkatëse të fitimit ose humbjes dhe të ardhurave të tjera të përgjithshme, pasqyrën e fluksit të parasë dhe pasqyrën e ndryshimeve të kapitaleve të veta, dhe të tjera shënime shpjeguese.

Përgjegjësitë e Drejtimit për Pasqyrat Financiare

Drejtimi është përgjegjës për përgatitjen dhe paraqitjen e sinqertë të këtyre pasqyrave financiare në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Raportimit Financiar dhe për kontrollin e brendshme që drejtimi i konsideron të nevojshme për përgatitjen e pasqyrave financiare që nuk përmbajnë anomali materiale, qoftë nga gabimet apo mashtrimet.

Përgjegjësitë e Audituesit të Pavarur

Përgjigjesia jonë është të shprehim një opinion mbi këto pasqyra financiare bazuar në auditimin tonë. Ne kemi kryer auditimin tonë në përputhje me Standartet Ndërkombëtare të Auditimit. Këto standarte kërkojnë që ne të jemi në përputhje me kërkesat etike dhe të planifikojmë dhe kryejmë auditimin për të përfutur siguri të arsyeshme që pasqyrat financiare nuk përmbajnë anomali materiale.

Një auditim përfshin kryerjen e procedurave për të siguruar evidencë auditimi në lidhje me vlerat dhe pohimet në pasqyrat financiare. Procedurat e përzgjedhura varen nga gjykimi i audituesit, duke përfshirë vlerësimin e rrezikut të anomalive materiale të pasqyrave financiare, si rezultat i gabimit apo mashtrimit. Gjatë vlerësimit të rrezikut audituesi konsideron kontrollin e brendshëm të përshtatshëm për përgatitjen e sinqertë të pasqyrave financiare të Shoqërisë me qëllim që të planifikojë procedura auditimi që janë të përshtatshme me rrethanat, por jo me qëllim për të shprehur një opinion mbi efektivitetin e kontrollit të brendshëm të Shoqërisë. Një auditim gjithashtu përfshin vlerësimin e përshtatshmërisë të politikave kontabël të përdorura dhe përshtatshmërinë e cmuarjeve kontabël të bëra nga drejtimi, si dhe vlerësimin e përgjithshëm të paraqitjes së pasqyrave financiare.

Ne besojmë se evidenca e auditimit që ne kemi marrë është e mjaftueshme dhe e përshtatshme për të siguruar bazat për opinionin tonë të auditimit.

Opinion

Sipas opinionit tone, pasqyrat financiare paraqesin në të gjitha aspektet materiale, në mënyrë të drejtë, pozicionin financiar të Shoqërisë Strabag AG – Dege e Shoqërisë se Huaj më datë 31 Dhjetor 2014 performancën e saj financiare dhe flukset e parasë për vitin e mbyllur në këtë datë në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Raportimit Financiar.

12 Mars 2015



Teit Gjini
Partner Angazhimi

 **MAZARS**
Rr. Emin Duraku, Pall "Binjaket",
No.5, 1000, Tirana, Albania
phone : +355 42 27 80 15
www.mazars.al , info@mazars.al

STRABAG AG – DEGE E SHOQERISE SE HUAJ
Pasqyra e pozicionit financiar më 31 Dhjetor 2014
(Vlerat janë në Lek)

		<i>2014</i>	<i>2013</i>
	<i>Shenimet</i>		
AKTIVET			
Aktive Afatgjata			
Aktive afatgjata materiale	5	63,809,929	79,762,412
Aktive Afatshkurtra			
Kerkesa te arketueshme	6	21,402,149	32,178,389
Kerkesa te tjera te arketueshme	7	42,846,252	90,287,872
Mjete Monetare	8	2,234,036	525,710
		66,482,437	122,991,971
TOTALI I AKTIVEVE		130,292,366	202,754,383
KAPITALI DHE DETYRIMET			
Kapitali			
Rezervat		8,979,944	8,979,944
Fitimi i pashperndare		75,591,175	81,414,598
Rezultati i vitit		1,631,017	(5,823,423)
Totali i kapitalit		86,202,136	84,571,119
Detyrimet afatshkurtra			
Llogari te pagueshme	9	1,877,175	4,865,245
Detyrime ndaj shtetit	10	384,846	253,206
Detyrime ndaj punonjesve	11	97,525	210,259
Provizione per gjoba	12	1,229,005	1,229,005
Te pagueshme te tjera ndaj paleve te lidhura	13	40,501,679	111,625,549
Totali i detyrimeve		44,090,230	118,183,264
TOTALI I KAPITALIT DHE DETYRIMEVE		130,292,366	202,754,383

Shënimet shpjeguese të faqeve 6 - 18 janë pjesë përbërëse e këtyre pasqyrave financiare.

STRABAG AG – DEGE E SHOQERISE SE HUAJ

Pasqyra e fitimit ose humbjes dhe të ardhurave të tjera të përgjithshme
për vitin e mbyllur më 31 Dhjetor 2014

(Vlerat janë në Lek)

		2014	2013
	<i>Shenime</i>		
Te ardhurat	14	33,094,820	12,050,204
Materialete para, te konsumueshme dhe sherbime		-	(84,285)
Kosto personeli	15	(12,022,062)	(7,814,839)
<i>Paga</i>		(11,459,857)	(7,487,930)
<i>Sigurime shoqerore e shendetesore</i>		(562,205)	(326,909)
Shpenzime te tjera	16	(4,608,532)	(7,261,314)
Amortizimi	5	(15,952,483)	(3,674,273)
FITIMI OPERATIV		511,743	(6,784,507)
Te ardhura financiare	17	1,049,383	476,821
Diferenca nga kursi i kembimit	18	69,891	484,263
Fitimi para tatimit		1,631,017	(5,823,423)
Tatim fitimi	19	-	-
FITIMI DHE TOTALI I TE ARDHURAVE TE PERGJITHSHME TE VITIT		1,631,017	(5,823,423)

Shënimet shpjeguese të faqeve 6 - 18 janë pjesë përbërëse e këtyre pasqyrave financiare.

STRABAG AG - DEGE E SHOQERISE SE HUAJ

Pasqyra e ndryshimeve në kapital për vitin e mbyllur më 31 Dhjetor 2014

(Vlerat janë në Lek)

	Kapitali Aksionar	Rezerva Ligjore	Rezultati Ushtrimor	Fitim i Pashperndare	Totali
Gjendja me 1 Janar 2013	-	8,979,944	(12,828,598)	94,243,196	90,394,541
Rezultati i vitit paraardhes	-	-	12,828,598	(12,828,598)	-
Fitim dhe te ardhurat e pergjithshme te vitit	-	-	(5,823,423)	-	(5,823,423)
Balanca me 31 Dhjetor 2013	-	8,979,944	(5,823,423)	81,414,598	84,571,119
Balanca me 1 Janar 2014	8,979,944	(5,823,423)	81,414,597	84,571,118	
Rezultati i vitit paraardhes	-	5,823,423	(5,823,423)	-	-
Fitim dhe te ardhurat e pergjithshme te vitit	-	-	1,631,017	-	1,631,017
Balanca me 31 Dhjetor 2014	-	8,979,944	1,631,017	75,591,174	86,202,135

Shënimet shpjeguese të faqeve 6 - 19 janë pjesë përbërëse e kësaj pasqyre financiare.

Këto pasqyra financiare janë aprovuar nga Bordi Drejtues ____ Mars 2015 dhe janë nënshkruar për publikim në emër të tyre nga:


 Frank Weimer
 Administrator


 Anxhela Kristo

Përgatitur nga:
 Znj. Anxhela Kristo

STRABAG AG – DEGE E SHOQERISE SE HUAJ

Pasqyra e rrjedhjes së parasë për vitin e mbyllur më 31 Dhjetor 2014

(Vlerat janë në Lek)

	2014 Leke	2013 Leke
FLUKSI NGA AKTIVITETI I SHFRYTEZIMIT		
Fitimi para tatimit	1,631,017	(5,823,423)
Rregullimi per:		
Amortizimin	15,952,483	3,674,273
Te ardhurat nga interesat	(1,049,383)	-
	16,534,117	(2,149,150)
Ndryshimet ne kapitalin punues		
Inventari dhe punimi ne proces		
Llogari te arketueshme dhe parapagimet	58,217,859	(25,809,217)
Llogari dhe te tjera te pagueshme	(74,093,033)	(16,944,780)
Mjete monetare neto nga aktiviteti i shfrytezimit	658,943	(44,903,147)
FLUKSI NGA AKTIVITETI I INVESTIMIT		
Blerje e Aktiveve Afatgjata materiale	-	(83,436,685)
Te ardhurat nga interesat	1,049,383	-
Mjete monetare nga aktiviteti i investimit	1,049,383	(83,436,685)
FLUKSI NGA AKTIVITETI I FINANCIMIT		
Mjete monetare neto nga aktiviteti i financimit	0	0
NDRYSHIMI NETO I MJETEVE MONETARE	1,708,326	(128,339,832)
Mjete monetare me 1 Janar	525,710	128,865,542
MJETE MONETARE ME 31 DHJETOR	2,234,036	525,710

Shënimet shpjeguese të faqeve 6 - 18 janë pjesë përbërëse e këtyre pasqyrave financiare.

1. INFORMACION I PËRGJITHSHËM

Strabag AG – Dege e Shoqerise se Huaj eshte dege e Strabag AG LLC regjistruar ne Shqiperi dhe angazhuar ne aktivitetet e ndertimit. Adresa e regjistruar e shoqerise eshte Rruga Bardhok Biba, Old Tirana Building, Tirane, Shqiperi. NIPTI i shoqerise eshte K74401601R dhe eshte regjistruar ne Korrik 2007.

2. APLIKIMI I STANDARDEVE NDËRKOMBËTARE TË RAPORTIMIT FINANCIAR TË REJA DHE TË RISHIKUARA (SNRF)

2.1 Standardet dhe interpretimet efektive ne periudhen aktuale

Standardet dhe interpretimet e meposhtme jane bere efektive prej 1 Janarit 2014:

Amendimi ne SNRF 32, "Kompensimi i Aktiveve Financiare dhe Detyrimeve Financiare" (emetuar ne Dhjetor 2011 dhe efektiv me ose pas 1 Janar 2014). Amendimi ka shtuar udhezime aplikimi per SNK 32 i cili adreson mosperputhjet e identifikuar ne aplikimin e disa prej kritereve te kompensimit. Kjo perfshin qartësimin e paragrafit "momentalisht ka nje te drejte te detyruar me ligj per kompensim" dhe qe disa sisteme te shlyerjes bruto mund te konsiderohen si ekuivalente te shlyerjeve neto. Standardi sqaroi se nje e drejte per komensim (a) nuk duhet te kushtëzohen nga ngjarje ne te ardhmen dhe (b) duhet te jete i detyrueshëm ligjërish ne te gjitha rrethanat ne vijim: (i) ne rrjedhën normale te biznesit, (ii) ne rast mosfunksionimi dhe (iii) ne rast falimentimi. Standardi i amenduar nuk ka nje impakt material ne pasqyrat financiare te Shoqerise.

Amendimi ne SNRF 10, SNRF 12, SNK 27 "Njesite ekonomike Investuese" (emetuar ne 31 Tetor 2012 dhe efektiv me ose pas 1 Janar 2014). Standardi i amenduar nuk ka nje impakt material ne pasqyrat financiare te Shoqerise.

Amendimi ne KIRFN 21, "Taksat" (emetuar ne 20 Maj 2013 dhe efektiv me ose pas 1 Janar 2014). Standardi i amenduar nuk ka nje impakt material ne pasqyrat financiare te Shoqerise.

Amendimi ne SNRF 36, "Dhenia e informacionit mbi shumat e rikuperueshme per aktivet jo-financiare" (emetuar ne Maj 2013 dhe efektiv me ose pas 1 Janar 2014; aplikimi i meparshem eshte i lejuar nqs eshte aplikuar SNRF 13 per periudhen kontabel dhe periudhen krahasuese). Standardi i amenduar nuk ka nje impakt material ne pasqyrat financiare te Shoqerise.

Amendimi ne SNRF 39, "Zevendesimi i Derivateve dhe vijimesia e Kontabilitetit Mbrojtes" (emetuar ne Qershor 2013 dhe efektiv me ose pas 1 Janar 2014). Standardi i amenduar nuk ka nje impakt material ne pasqyrat financiare te Shoqerise.

2. APLIKIMI I STANDARDEVE NDËRKOMBËTARE TË RAPORTIMIT FINANCIAR TË REJA DHE TË RISHIKUARA (SNRF) (VAZHDIM)

2.2 Standardet dhe interpretimet e emetuara por ende te pa përvetësuara

Ne datën e aprovimit të këtyre pasqyrave financiare, standardet e mëposhtme, interpretimet dhe rishikimet janë emetuar por nuk janë ende efektive:

- SNRF 9 "Instrumentat financiarë: klasifikimi dhe matja" (amenduar në Korrik 2014 dhe efektive për periudhat me ose pas 1 Janar 2018).
- Amendime në SNK 19 – "Skemat e përfitimeve të përcaktuara: Kontributet e punonjësve" (emetuar në Nëntor 2013 dhe efektive për periudhat që fillojnë me 1 Korrik 2014).
- Përmirësimet vjetore për SNRF-të 2012 (emetuar në Dhjetor 2013 dhe efektive për periudhat që fillojnë me ose pas 1 Korrik 2014, përveç kur shprehet ndryshe më poshtë).
- Përmirësimet vjetore për SNRF-të 2013 (emetuar në Dhjetor 2013 dhe efektive për periudhat që fillojnë me ose pas 1 Korrik 2014).
- SNRF 14, Llogaritë rregullatore e shtyrjes (emetuar në Janar 2014 dhe efektive për periudhat që fillojnë me ose pas 1 Janar 2016).
- Kontabilizimi për blerjet e interesave në Operacionet e Përbashkëta – Amendime në SNRF 11 (emetuar më 6 Maj 2014 dhe efektive për periudhat që fillojnë me ose pas 1 Janar 2016).
- Qartësimi i metodave të pranueshme për Amortizimin dhe Zhvlerësimin – Amendime në SNK 16 dhe SNK 38 (emetuar më 12 Maj 2014 dhe efektive për periudhat me ose pas 1 Janar 2016).
- SNRF 15, Të ardhurat nga Kontratat me Klientet (emetuar më 28 Maj 2014 dhe efektive për periudhat që fillojnë me ose pas 1 janar 2017).
- Bujqësi: Bimet Prodhuese – Amendime në SNK 16 dhe SNK 41 (emetuar më 30 Qershor 2014 dhe efektive për periudhat që fillojnë me 1 Janar 2016).
- Metoda e kapitalit në pasqyrat financiare individuale – Amendimet në SNK 27 (emetuar më 12 Gusht 2014 dhe efektive për periudhat që fillojnë me 1 Janar 2016).
- Shitje ose Kontribut në asetet midis një investitori dhe bashkëpunëtorit të tij ose sipërmarrjes së përbashkët – Amendime në SNRF 10 dhe SNK 28 (emetuar më 11 Shtator 2014 dhe efektive për periudhat që fillojnë me ose pas 1 Janar 2016).
- Përmirësimet vjetore për SNRF-të 2014 (emetuar në 25 Shtator 2014 dhe efektive për periudhat që fillojnë me ose pas 1 Janar 2016).
- Dhenia e informacioneve shpjeguese sipas Amendimeve të SNK 1 (emetuar në Dhjetor 2014 dhe efektive për periudhat me ose pas 1 Janar 2016).
- Njësitë ekonomike investuese: Aplikimi i Përfashtimit të Konsolidimit amendim në SNRF 10, SNRF 12 dhe SNK 28 (emetuar në Dhjetor 2014 dhe efektive për periudhat me ose pas 1 Janar 2016).

Kompania ka zgjedhur të mos i përvetësojë këto standarde, rishikime dhe interpretime para datës që ato do të bëhen efektive. Kompania parashikon se përvetësimi i këtyre standardeve, rishikimeve dhe interpretimeve nuk do të ketë ndikim material në pasqyrat financiare të kompanisë në periudhën e aplikimit fillestar të tyre.

Të gjitha vlerat janë në Lek, përveç kur shprehet ndryshe

3. BAZAT E PËRGATITJES

(a) Deklarata e pajtueshmërisë

Pasqyrat financiare janë përgatitur në përputhje me Standardet Nderkombetare të Raportimit Financiar (SNRF).

(b) Baza e matjes

Pasqyrat financiare janë përgatitur në përputhje me Standardet Nderkombetare të Raportimit Financiar (SNRF) të leshuara nga Bordi i Standardeve Nderkombetare të Kontabilitetit ("BSNK") dhe interpretimet e nxjerra nga Komiteti për Interpretimet Nderkombetare të Raportimit Financiar ("KIRFN") të BSNK-se.

Pasqyrat financiare janë përgatitur mbi bazën e kostos historike.

(c) Monedha funksionale dhe e paraqitjes

Këto pasqyra financiare janë prezantuar në Lek Shqiptar ("Lek"), e cila është monedha funksionale e Shoqërisë.

(d) Përdorimi i vlerësimeve dhe gjykimeve

Përgatitja e këtyre pasqyrave financiare në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Raportimit Financiar kërkon që Drejtimi të bëjë gjykimet, vlerësimet dhe supozimet të cilat ndikojnë në aplikimin e politikave kontabël dhe shumat e raportuara të aktiveve, detyrimeve, të ardhurave dhe shpenzimeve. Rezultatet faktike mund të ndryshojnë si pasojë e këtyre vlerësimeve.

Vlerësimet dhe supozimet rishikohen në mënyrë të vazhdueshme. Rishikimet e vlerësimeve kontabël njihen në periudhën në të cilën vlerësimi rishikohet dhe në periudhat e ardhshme nëse ato ndikohen.

4. POLITIKA TË RËNDËSISHME KONTABËL

Politikat kontabël të paraqitura më poshtë janë aplikuar në të gjitha periudhat e pasqyruara në këto pasqyra financiare dhe në mënyrë të vazhdueshme nga Shoqëria.

(a) Te ardhurat nga kontratat dhe fitimi

Të ardhurat nga kontratat përfshijnë vlerën totale të punës ndërtimore të kryer gjatë vitit. Fitimi nga kontratat afatgjata njihet me përqindjen e rregulluar mbi bazë të përfundimit. Asnjë fitim nuk merret deri kur një kontratë nuk ka avancuar deri në pikën ku fitimi përfundimtar i realizueshëm mund të përcaktohet në mënyrë të arsyeshme. Provizionet janë krijuar për të gjitha humbjet e shkaktuara në datën e raportimit plus për çdo humbje të mëtejshme të parashikuar për sjelljen e kontratave drejt përfundimit.

(b) Transaksionet në monedhë të huaj

Transaksionet në monedhë të huaj konvertohen në monedhën funksionale me kursin e këmbimit në datën e transaksionit. Aktivët dhe detyrimet monetare në monedhë të huaj në datën e raportimit konvertohen në monedhën funksionale me kursin e asaj date. Zërat jo monetare maten në bazë të kostos historike dhe nuk konvertohen në datën e raportimit.

Diferencat nga kursi i këmbimit nga zërat monetarë, njihen në fitim ose humbje të periudhës të cilës i përkasin.

Të gjitha vlerat janë në Lek, përveç kur shprehet ndryshe

4. POLITIKA TE RENDESISHME KONTABEL (VAZHDIM)

(b) Transaksionet në monedhë të huaj (vazhdim)

Fitimi dhe humbja nga monedha e huaj, raportohen në baza neto.

	31 Dhjetor 2014	31 Dhjetor 2013
Euro	140.14	140.20

(c) Instrumenta financiarë

Aktivitet dhe detyrimet financiarë njihen në datën e tregtimit në të cilën Shoqëria bëhet palë e detyrimeve kontraktuale të instrumentit. Fillimisht Shoqëria i regjistron aktivitet dhe detyrimet financiare me vlerë e drejtë. Matja e mëvonshme për secilin instrument financiar, është e detajuar në shënimet e mëposhtme.

Shoqëria ç'rregjistron një aktiv financiar kur të drejtat kontraktuale mbi rrjedhën e parasë nga aktivi skadojnë ose në qoftë se transferon të drejtat për të arkëtuar flukset kontraktuale të parasë të aktivitet financiar në një transaksion në të cilin pothuajse të gjithë rreziqet dhe përfitimet e zotërimit të aktivitet financiar transferohen. Çdo interes në aktivitet financiare të transferuara që është krijuar apo përfituar prej Shoqërisë njihet si një aktiv apo detyrim i veçantë.

Aktivitet dhe detyrimet financiare kompesohen dhe vlera neto e tyre paraqitet në pasqyrën e pozicionit financiar vetëm kur Shoqëria ka një të drejtë ligjore për të kompesuar vlerat dhe synon ose të shlyejë në bazë neto ose të përftojë aktivin dhe shlyejë detyrimin në të njëjtën kohë. Instrumentat financiarë jo derivative të Shoqërisë përbëhen nga llogaritë e arkëtueshme dhe të tjera, mjete monetare dhe ekuivalente të tyre, detyrimet tregtare dhe të tjera.

Mjetet monetare dhe ekuivalentet e tyre

Mjetet monetare dhe ekuivalentet e tyre përbëhen nga paraja në arkë, llogaritë rrjedhëse bankare dhe depozitat me afat maturimi me më pak se tre muaj.

Llogaritë e pagueshme

Llogaritë e pagueshme dhe të tjera janë deklaruar me vlerën e drejtë dhe më pas me koston e tyre të amortizuar duke përdorur metodën e interesit efektiv.

Të tjera

Të tjera instrumenta financiarë jo derivative janë matur me koston e tyre të amortizuar duke përdorur metodën e interesit efektiv duke zbritur humbjet nga zhvlerësimi.

Huatë

Huate janë njohur fillimisht me vlerën e drejte, neto nga kostot e transaksioneve dhe me pas njihen me koston e amortizuar duke përdorur metodën e interesit efektiv, me shpenzime interesi të njohura bazuar në normen efektive.

Metoda e interesit efektiv është metoda e llogaritjes të koston të amortizuar të detyrimit financiar dhe e alokimit të shpenzimit të interesit përgjate periudhës perkatese. Norma efektive e interesit është norma që skanton saktësisht vlerat e ardhshme të parave përgjate jetegjatesise së planifikuar të detyrimit financiar, ose, kur është e pershtatshme, për një periudhë me të shkurter vlerën e mbetur neto nga njohja fillestare.

(d) Aktive afatgjata materiale

(i) Njohja dhe matja

Zërat e aktiveve afatgjata materiale janë matur me kosto duke zbritur amortizimin e akumuluar dhe humbjet nga zhvlerësimi i akumuluar.

Të gjitha vlerat janë në Lek, përveç kur shprehet ndryshe

4. POLITIKA TË RËNDËSISHME KONTABËL (VAZHDIM)

(e) Aktive afatgjata materiale (vazhdim)

Kostot përfshijnë shpenzimet që janë të lidhura direkt me blerjen e aktivit. Kosto e aktivit të ndërtuar vetë përfshin koston e materialeve dhe punës direkte dhe çdo kosto tjetër direkte të lidhur me vënien e aktivit në kushtet e punës për përdorimin e parashikuar, kostot e çmontimit dhe heqjen e pjesëve dhe restaurimin e zonës në të cilat ato janë vendosur dhe kostot e huamarrjes së kapitalizuara. Programi i blerë që është pjesë përbërëse në funksionimin e një pajisjeje është kapitalizuar si pjesë e pajisjes.

Kur pjesë të një zëri të aktiveve afatgjata materiale kanë jetëgjatësi të ndryshme, ato llogariten si zëra të ndara (pjesë të rëndësishme) të akteveve afatgjata materiale.

Fitimet ose humbjet nga nxjerrja jashtë përdorimit e ndonjë zëri të akteveve afatgjata materiale janë përcaktuar duke krahasuar të ardhurat e marra nga nxjerrja jashtë përdorimit me vlerën kontabël (neto) të akteveve afatgjata materiale dhe janë pasqyruar neto në të ardhura të tjera në pasqyrën e fitimit ose humbjes.

(ii) Kostot vijuese

Kostoja e zëvendësimit të një pjese të pronave, makinerive dhe pajisjeve është njohur në vlerën kontabël (neto) të pjesës në qoftë se është e mundur që në të ardhmen të mirat ekonomike të përfshira në atë pjesë do t'i vijnë Shoqërisë dhe kostoja mund të matet me besueshmëri. Vlera kontabël (neto) e pjesës që zëvendësohet hiqet nga regjistrimet. Kostot e shërbimeve të përditshme të pronave, makinerive dhe pajisjeve janë të njohura në të ardhurat ose shpenzimet kur ndodhin.

(iii) Amortizimi

Amortizimi është llogaritur mbi vlerën e amortizueshme, e cila është kostoja e aktivit duke zbritur vlerën e mbetur.

Amortizimi njihet me normatsi më poshtë në bazë të vlerës së mbetur:

Ndertesa	5%
Mobilje dhe orendi	20%
Mjetet e transportit	20%
Pajisje kompjuterike	25%
Makineri dhe pajisje	20%

(e) Kostot e huamarrjes

Kostot e huave të lidhura direkt me blerjen, ndërtimin ose prodhimin të aktiveve, të cilat duan një kohë të gjatë për t'u sjellë në formë përfundimtare, në mënyrë që të përdoren apo shiten, i shtohen kostos së këtyre aktiveve. Kostot e huamarrjes kanë të bëjnë me interesin dhe kosto të tjera që janë bërë nga një shoqëri në lidhje me marrjen e fondeve.

Të gjitha kostot e tjera njihen si të ardhura ose shpenzime në periudhën kur ato kanë ndodhur.

(f) Zhvlerësimi

(i) Aktivet financiare

Një aktiv financiar jo i mbartur me vlerë të drejtë nëpërmjet fitimit dhe humbjes është vlerësuar në çdo datë raportimi për të përcaktuar nëse ka ndonjë evidencë objektive për ta zhvlerësuar. Një aktiv financiar konsiderohet i zhvlerësuar nëse ka evidencë objektive që tregojnë se një ngjarje zhvlerësimi ka ndodhur pas njohjes fillestare të aktivit dhe ka patur një ndikim negativ në rrjedhjen e ardhshme monetare të vlerësuar të aktivit financiar dhe këto efekte janë të matshme në mënyrë të besueshme.

Të gjitha vlerat janë në Lek, përveç kur shprehet ndryshe

4. POLITIKA TË RËNDËSISHME KONTABËL (VAZHDIM)

(f) Zhvlerësimi (vazhdim)

Një humbje nga zhvlerësimi në lidhje me një aktiv financiar të matur me kosto të amortizuar është llogaritur si diferencë mes vlerës kontabël dhe vlerës aktuale të flukseve të ardhshme të parasë të vlerësuar duke i skontuar me normën origjinale efektive të interesit të aktivit. Humbjet janë njohur në të ardhura dhe shpenzime dhe janë reflektuar në një llogari zbritje nga llogaritë e arkëtueshme. Interesi mbi një aktiv të zhvlerësuar vazhdon të njihet nëpërmjet skontimit të qendrueshëm. Kur një ngjarje e ardhshme (p.sh. shlyerja e një debitori) shkakton një rënie në shumën e humbjes nga zhvlerësimi, rënia në humbjen nga zhvlerësimi rimerret nëpërmjet fitimit ose humbjes.

(iii) Aktive jo financiare

Vlerat kontabël të aktiveve jofinanciare të Shoqërisë janë rishikuar në datën e raportimit për të përcaktuar në qoftë se ka ndonjë tregues zhvlerësimi. Në qoftë se ndonjë tregues i tillë ekziston, atëherë llogaritet vlera e rikuperueshme e aktivit. Shuma e rikuperueshme është vlera më e lartë midis vlerës së drejtë minus kostot e shitjes dhe vlerës në përdorim. Në vlerësimin e vlerës në përdorim, flukset e vlerësuar monetare të ardhshme janë zbritur për vlerën e tyre aktuale duke përdorur një normë skontimi para taksave që reflekton vlerësimet aktuale të tregut për vlerën në kohë të parasë dhe risqet specifike për aktivin për të cilat vlerësimet e flukseve monetare të ardhshme nuk janë rregulluar.

Humbjet nga zhvlerësimi njihen në qoftë se vlera e mbartur e aktivit apo pjesa e burimit të parave e kalon vlerën e rikuperueshme. Humbjet nga zhvlerësimi janë njohur në të ardhura ose shpenzime.

(g) Provigjonet

Një provigjon njihet në qoftë se, si rezultat i ngjarjeve në të kaluarën, Shoqërisë i lindin detyrime ligjore ose konstruktive të cilat mund të parashikohen me besueshmëri dhe është e mundur që të ndodhë një dalje e përfitimeve ekonomike për shlyerjen e detyrimit. Provigjonet janë përcaktuar duke ju zbritur vlerën e pritshme të flukseve të parasë të skontuara me një normë para tatimit që reflekton vlerësimet aktuale të tregut për vlerën në kohë të parasë dhe risqet specifike të detyrimeve. Skontimi i qëndrueshëm është njohur si kosto financiare.

(h) Pagesat e qirasë

Pagesat e bëra për qiratë e zakonshme janë njohur në të ardhura ose shpenzime në mënyrë lineare gjatë afatit të qirasë. Lehtësirat e përfituara të qirasë janë njohur si pjesë përbërëse e shpenzimeve totale të qirasë, gjatë afatit të qirasë.

(i) Përfitimet e punëmarrësve

Kontributet e detyrueshme shoqërore

Një plan i kontributit të përcaktuar është një plan përfitimi pas periudhës së punësimit sipas të cilit një njësi ekonomike paguan kontribute në shuma fikse në një entitet të veçantë dhe nuk ka asnjë detyrim ligjor apo konstruktiv për të paguar shuma të mëtejshme. Qeveria e Shqipërisë është përgjegjëse për sigurimin e pensioneve në Shqipëri, sipas një plani të përcaktuar të kontributeve të pensionit. Kontributet e Shoqërisë në planin e përcaktuar të kontributeve të pensionit njihen si një shpenzimi përfitimit të punonjësve në të ardhura dhe shpenzime në periudhat gjatë të cilave kryhen shërbimet nga të punësuarit.

(j) Të ardhurat dhe shpenzimet financiare

Të ardhurat financiare përfshijnë të ardhurat nga interesat për fondet e depozituara në bankë dhe fitimet nga kurset e këmbimit. Të ardhurat nga interesat njihen kur realizohen duke përdorur metodën e interesit efektiv.

Shpenzimet financiare përfshijnë shpenzimet e interesit, humbjet nga kurset e këmbimit dhe humbjet nga zhvlerësimi të njohura në aktivet financiare.

Të gjitha vlerat janë në Lek, përveç kur shprehet ndryshe

4. POLITIKA TË RËNDËSISHME KONTABËL (VAZHDIM)

(k) Tatimi mbi fitimin

Tatimi mbi fitimin përbëhet nga tatimi i periudhës dhe tatimi i shtyrë. Tatimi mbi fitimin njihet në të ardhura ose shpenzime përveç rasteve kur lidhen me zëra të njohur direkt në kapital apo në të tjera të ardhura gjithëpërfshirëse.

Tatimi i periudhës është tatimi i pritshëm për t'u paguar apo arkëtuar mbi fitimin e tatueshëm apo humbjen për vitin, duke përdorur normat e tatimeve që kanë hyrë ose do të hyjnë në fuqi deri në datën e raportimit dhe çdo sistemim mbi tatimin e pagueshëm të lidhur me vitet e mëparshme.

Tatimi i shtyrë njihet duke paraqitur diferencat e përkohshme midis vlerave kontabël të aktiveve dhe detyrimeve për qëllime raportimi financiar dhe vlerave të përdorura për qëllime tatimore. Tatimi i shtyrë matet me normat tatimore që priten të aplikohen për diferencat e përkohshme kur ato të kthehen, duke përdorur normat e tatimeve që kanë hyrë ose do të hyjnë në fuqi deri në datën e raportimit.

Një aktiv për tatimin e shtyrë njihet nëse është e mundshme që të ardhura të tatueshme të ardhshme do të realizohen kundrejt të cilave mund të përdoren diferencat e përkohshme. Aktivet e tatimit të shtyrë rishikohen në çdo datë raportimi dhe zvogëlohen deri sa nuk janë më të mundshme të realizohen përfitime tatimore të lidhura me të.

Në përcaktimin e vlerës së tatimit të periudhës dhe tatimit të shtyrë Shoqëria merr në konsideratë ndikimin e pasigurtë të pozicionit të taksave dhe nëse mund të ngarkohen taksa shtesë ose interesa. Shoqëria beson se shpenzimet e përlllogaritura të saja për detyrimet tatimore janë të përshtatshme për të gjitha vitet tatimore të hapura bazuar në vlerësimin e saj për shumë faktorë, duke përfshirë interpretime të ligjit të taksave dhe përvojave të mëparshme. Ky vlerësim mbështetet nëparashikime dhe supozime dhe mund të përfshijë një seri gjykimesh për ngjarjet e ardhshme. Informacione të reja mund të bëhen të disponueshme duke ndikuar në ndryshimin e vendimit të Shoqërisë në lidhje me përshtatshmërinë e detyrimeve tatimore ekzistuese; ndryshime të tilla në detyrimet tatimore do të ndikojë në shpenzimet tatimore në periudhën që është bërë një përcaktim i tillë.

(l) Inventaret

Inventare njihen me me te voglen mes kosos dhe vleres neto te realizueshme. Kosot jane ato shpenzime te kryera per te sjelle cdo produkt ne vendndodhjen dhe kushtet aktuale deh percaktohen ne baze te kosos mesatare te ponderuar.

Vlera neto e realizueshme bazohet ne cmimin e vleresuar te shitjes minus cdo kosto qe pritet te ndodhe ne perfundim apo ne nxjerrjen jashte perdorimit.

(m) Prodhimi ne process

Prodhimi ne proces ne kontratat afatgjata llogaritet me kosto plus fitimin qe i atribuohet, ne masen qe eshte e arsyeshme me pas krijimi provizioneve per kontigjencat, minus ndonje humbje te ndodhur ose te parashikuar per te sjelle kontratat drejt perfundimit dhe minus shumat e arketuara ose per tu arketuar si pagesa ne progres. Per kete arsye, kostot perfshijne te gjitha kostot direkte te kontratave, per cdo kontrate kur arketimet plus te arketueshmet tejkalojne vleren kontabel te punes se kryer diferenca e shtuar perfshihet ne llogarite e pagueshme dhe te shtyrat.

(n) Llogarite e arketueshme

Llogarite e arketueshme jane ne vleren origjinale te fatures minus nje provizion per vlerat e pa arketueshme. Nje perlllogaritje e te arketueshmeve te dyshimta behet kur arketimi i vleres se plote nuk eshte me i mundur. Borxhi i keq cregjistrohet ne rast se nuk ka mundesi marrje.

STRABAG AG – DEGE E SHOQERISE SE HUAJ
Shënime mbi pasqyrat financiare më dhe për vitin e mbylltur më 31 Dhjetor 2014

Të gjitha vlerat janë në Lek, përveç kur shprehet ndryshe

5. AKTIVET AFATGJATA MATERIALE

Aktivët afatgjata materiale përbëhen si më poshtë:

Pershkrimi	Ndertesa	Mjete Transporti	Makineri dhe paisje	Mobilje e Orendi	Pajisje Informatike	Aktive ne Proces	Totali
Vlera Kontabel bruto:							
Me 1 Janar 2013				83,436,685			83,436,685
Shtesa							
Me 31 Dhjetor 2013				83,436,685			83,436,685
Amortizimi:							
Me 1 Janar 2013							
Amortizimi I vitit				3,674,273			3,674,273
Me 31 Dhjetor 2013				3,674,273			3,674,273
Vlera Kontabel Neto :							
Me 31 Dhjetor 2013				79,762,412			79,762,412
Vlera Kontabel bruto:							
Me 1 Janar 2014				83,436,685			83,436,685
Me 31 Dhjetor 2014				83,436,685			83,436,685
Me 1 Janar 2013				3,674,273			3,674,273
Amortizimi I vitit				15,952,483			15,952,483
Me 31 Dhjetor 2014				19,626,756			19,626,756
Vlera Kontabel Neto :							
Me 31 Dhjetor 2014				63,809,929			63,809,929

STRABAG AG – DEGE E SHOQERISE SE HUAJ**Shënime mbi pasqyrat financiare më dhe për vitin e mbyllur më 31 Dhjetor 2014**

Të gjitha vlerat janë në Lek, përveç kur shprehet ndryshe

6. LLOGARITE E ARKETUESHME

Pershkrimi	2014	2013
Strabag Turkey Branch	-	2,621,741
Trema Engineering 2 shpk	18,388,914	26,543,413
UK Shkodra	3,013,235	3,013,235
Totali	21,402,149	32,178,389

7. KERKESA TE TJERA TE ARKETUESHME

Pershkrimi	2014	2013
Strbag Oman - Dega Shqiperi	2,093,692	35,856,640
Pomgrad - Dega Shqiperi	-	7,114,229
Parapagimi - tatim fitimi	32,368,058	32,368,058
Hua te dhena	-	155,563
TVSh e arketueshme	8,384,502	14,793,382
Totali	42,846,252	90,287,872

8. MJETET MONETARE

Mjete monetare dhe ekuivalente të tyre përbëhen si më poshtë:

Pershkrimi	2014	2013
Paraja ne Arke	112,221	41,879
Paraja ne Banke	2,121,815	483,831
Totali	2,234,036	525,710

9. LLOGARITE E PAGUESHME DHE TE SHTYRAT

Pershkrimi	2014	2013
Strabag AG Vienna	1,332,789	4,623,369
Interalbanian	-	173,780
Te tjera te pagueshme	544,386	68,096
Totali	1,877,175	4,865,245

10. DETYRIMET NDAJ SHYTETIT

Pershkrimi	2014	2013
Sigurime shoqerore es shendetesore	76,545	53,083
Tatimi mbi te ardhurat personale	308,301	200,123
Totali	384,846	253,206

11. DETYRIMET NDAJ PUNONJESVE

Pershkrimi	2014	2013
Paga	97,525	210,259
Totali	97,525	210,259

STRABAG AG – DEGE E SHOQERISE SE HUAJ

Shënime mbi pasqyrat financiare më dhe për vitin e mbyllur më 31 Dhjetor 2014

Të gjitha vlerat janë në Lek, përveç kur shprehet ndryshe

12. PROVIZIONE PER GJOBA

Pershkrimi	2014	2013
Provizione per gjoba	1,229,005	1,229,005
Totali	1,229,005	1,229,005

13. TE PAGUESHME TE TJERA NDAJ PALEVE TE LIDHURA

	2014	2013
Strabag AG Vienna	40,501,679	111,625,549
Totali	40,501,679	111,625,549

14. TE ARDHURAT

	2014	2013
Te ardhura nga dhenia me qera e AAM-ve	29,773,502	10,888,600
Te tjera te ardhura	3,321,318	1,161,604
Totali	33,094,820	12,050,204

15. KOSTO PERSONELI

	2014	2013
Paga	11,459,857	7,487,930
Sigurime shoqerore e shendetesore	562,205	326,909
Totali	12,022,062	7,814,839

16. SHPENZIME TE TJERA

	2014	2013
Sherbime nga palet e treta	-	-
Sherbime konsulence	543,270	1,230,187
Shpenzime Qiraje	167,328	140,007
Kancelari	-	-
Staf i huaj	-	-
Udhetime e dieta	635,029	314,230
Shpenzime Postare	15,450	1,100
Shpenzime transporti	-	126,160
VKN e AQT- ve te shitura	-	-
Penalitete	5,642	43,883
Shpenzime provizioni	-	1,229,005
Te tjera shpenzime	3,241,813	4,176,742
Totali	4,608,532	7,261,314

17. TE ARDHURA FINANCIARE

	2014	2013
Te ardhura te tjera nga interesat	1,049,383	456,537
Te ardhura te tjera financiare	-	20,284
Totali	1,049,383	476,821

STRABAG AG – DEGE E SHOQERISE SE HUAJ**Shënime mbi pasqyrat financiare më dhe për vitin e mbyllur më 31 Dhjetor 2014**

Të gjitha vlerat janë në Lek, përveç kur shprehet ndryshe

18. DIFERENCA NGA KURSI I KEMBIMIT

	2014	2013
Diferenca pozitive nga kursi i kembimit	1,684,949	829,750
Diferenca negative nga kursi i kembimit	(1,615,058)	(345,487)
Totali	69,891	484,263

19. TATIM FITIMI

	2014	2013
Pasqyra e te ardhurave gjithëpërshirëse:		
Fitimi/(humbja) kontabel	1,631,017	(5,823,423)
<i>Rregullimet per:</i>		
Shpenzime per personelin	-	272,480
Shpenzime akomodimi	635,029	-
Shpenzime postare	8,700	1,100
Shpenzime te panjohura	43,000	1,400
Gjoha penalitete	5,642	1,272,888
Shpenzime te tjera	612,683	992,745
Total shpenzime te panjohura	1,305,054	2,540,613
Fitim / (humbja) i tatueshem	2,936,071	(3,282,810)
 Humbja e mbartur	 (52,917,668)	 (49,634,858)
Shpenzimi tatim fitimi (15% i fitimit te tatueshem: 10% ne 2013)	-	-

Humbjet fiskale mund te mbarten deri ne 3 vjet.

Humbja e vitit 2011 eshte perdorur per te ardhurat fiskale te vitit 2014.

	2014	2013
Humbja fiskale e 2011 (skadon ne 2014)	(49,634,858)	(49,634,858)
Humbja fiskale e 2013 (skadon ne 2016)	(3,282,810)	(3,282,810)
Fitimi i tatueshem i 2014	2,936,071	
Totali	(49,981,597)	(52,917,668)

20. PALËT E LIDHURA

	2014	2013
Shpenzimet	1,632,362	788,254
Strabag AG - Vienna	1,632,362	788,254
Trema Engineering 2	-	-
 Blerje e Pajisjeve	 -	 11,415,363
BMTI baumachinetechnik		7,551,915
Strabag SRL Romania		3,863,448
 Shitje	 33,094,820	 12,050,204
Trema Engineering 2	22,719,959	6,404,624
Pomgrad Inzenjering – Dege e shoqerise se huaj	3,155,234	5,645,580
Strabag Oman- Dege e shoqerise se huaj	7,219,627	
 Te ardhura te tjera - Interesa	 1,049,383	 476,821
Pomgrad Inzenjering - Dege e shoqerise se huaj		341,181

STRABAG AG – DEGE E SHOQERISE SE HUAJ**Shënime mbi pasqyrat financiare më dhe për vitin e mbyllur më 31 Dhjetor 2014**

Të gjitha vlerat janë në Lek, përveç kur shprehet ndryshe

Strabag Oman- Dege e shoqerise se huaj	1,049,383	135,640
--	-----------	---------

Balancat me palet e lidhura te perfshira ne pasqyren e pozicionit financiar jane si me poshte:

	2014		2013	
	Te pagueshme, hua dhe te shtyra	Te arketueshme	Te pagueshme, hua dhe te shtyra	Te arketueshme
Trema Engineering 2	84,084	18,472,998	-	26,543,412
Pomgrad Inzenjering – Dege e Shoqerise se huaj	-	-	-	7,114,229
Strabag AG Vienna	41,834,468	-	116,248,918	-
Strabag Oman	-	2,093,692	-	35,856,640
Strabag Turqi	-	-	-	2,621,740
Totali	41,918,552	20,566,690	116,248,918	72,136,021

Gjendja ende e papaguar ne fund te vitit lindin nga rrjedha normale e biznesit. Nuk ka nevojë për zhvleresim.

21. MANAXHIMI I RISKUT FINANCIAR**Risku i normave te interesit**

Shoqeria eshte e ekspozuar ndaj riskut te normave te interesit per shkak te normave te interesit te kredive te marra. Megjithate duke marre ne konsiderate qe interesi eshte shume i ulet dhe huaja eshte afatshkurter luhetjet ne normen e interesit jane te pa rendesishme.

Risku i kreditit

Shoqeria kerkon te kufizojë riskun e kreditit ne lidhje me klientet e saj duke monitoruar arketimet e pambledhura. Projekti per ndertimin e portit eshte financuar nga Banka Islamike per Zhvillim dhe fondet jane bene ne dispozicion per fillimin e punes. Per shkak te ketij fakti, edhe pse shoqeria ka vetem nje klient, risku i kredise eshte i ulet.

Risku i kreditit eshte i kufizuar ne vleren kontabel te aktiveve financiare ne daten e raportimit.

Risku i Likuiditetit

Shoqeria e kufizon riskun e likuiditetit duke siguruar fasilite (kredi) bankare ne dispozicion. Termat e shitjes te shoqerise kerkojne qe shumet te paguhen brenda 42 diteve nga data e leshimit te fatures. Pjesa me e madhe e llogarive te pagueshme tregtare jane vendosur zakonisht sipas metodës Back to Back (psh pasi shoqeria ka arketuar parate nga klienti).

Tabela e meposhte permbledh maturimet e detyrimeve financiare te paskontuara te shoqerise me 31 dhjetor 2014, bazuar ne datat e pagesave kontraktuale dhe normat aktuale te interesit te tregut.

Viti i mbyllur me 31 Dhjetor 2014	Me pak se 3 muaj	3 deri 12 muaj	1 deri 5 vjet	> 5 vjet	Totali
Te pagueshme ndaj furnitoreve	544,387	41,834,468			42,378,855
Detyrime ndaj shtetit	384,846				384,846
Detyrime ndaj punonjeseve	97,525				97,525
Total	1,026,758	41,834,468			42,861,226

STRABAG AG – DEGE E SHOQERISE SE HUAJ**Shënime mbi pasqyrat financiare më dhe për vitin e mbyllur më 31 Dhjetor 2014**

Të gjitha vlerat janë në Lek, përveç kur shprehet ndryshe

Viti i mbyllur me 31 Dhjetor 2013	Me pak se 3 muaj	3 deri 12 muaj	1 deri 5 vjet	> 5 vjet	Totali
Te pagueshme ndaj furnitoreve			116,248,918		116,248,918
Detyrime ndaj shtetit	253,206				253,206
Detyrime ndaj punonjesve	210,259				210,259
Totali	463,465		116,248,918		116,712,383

Risku i valutes

Shoqeria ndërmerr transaksione në monedhe të huaj si pasojë e ekspozimit ndaj luhatjeve të kurseve të këmbimit. Ekspozimi ndaj kurseve të këmbimit menaxhohet duke përcaktuar një politikë midis të arketueshmeve dhe të pagueshmeve. Vlera kontabel neto e aktiveve dhe detyrimeve monetare të shoqërisë sipas monedhave për vitin që u mbyll janë paraqitur në tabelën e mëposhtme:

	2014		2013	
	Detyrimet	Aktivet	Detyrimet	Aktivet
Leke	1,026,758	66,370,682	705,341	77,132,542
Euro	41,834,468	111,692	116,248,918	45,859,511

22. BURIMET KRYESORE NË VLERESIMIN E PASIGURISE*Zhvlerësimi i llogarive të arketueshme*

Një vlerësim i shumës së mbledhshme të llogarive të arketueshme tregtare kryhet kur arketimi i shumës së plote nuk është me e mundur. Për shumat individuale të rendesishme, ky vlerësim është kryer në baza individuale. Shumat të cilat nuk janë të rendesishme individualisht, por që janë të vonuara, vlerësohen në mënyrë kolektive dhe aplikohet një provizion në përputhje me gjatësinë e kohës së vonuar, bazuar në normat historike të rikuperimit.

Në datën e raportimit nuk ka ndonjë tregues që llogaritë e arketueshme të jenë zhvlerësuar.

23. NGJARJE PAS DATËS SË RAPORTIMIT FINACIAR

Nuk ka ngjarje të rëndësishme pasdatës së raportimit të cilat do të kërkonin korrigjim ose shënime në pasqyrat financiare.

MAZARS SHPK

Address: Rruga Emin Duraku,
Pall. Binjaket, No.5
Tirana, 1000
Tel. +355 4 222 2889
Fax. +355 4 222 2889
E-mail: audit@mazars.al

www.mazars.al